

Data \_\_.\_\_.2024

## PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Furnizim me materiale të mjekimit specifike për shërbimet mjekësore në SUT” për një periudhë 24 mujore e ndare ne 2 lote:**

- **LOTI 1** - “Blerje materiale mjekimi specifike për Kirurgji gastrointestinale dhe laparoskopike në SUT”.
- **LOTI 2** - “Blerje materiale konsumi për Artroskopinë e SUT”

**VLERA E FONDIT LIMIT: 56,144,623.34** (pesëdhjetë e gjashtë milionë e njëqind e dyzet e katër mijë e gjashtëqind e njëzet e tre pik tridhjetë e katër) **Lekë pa TVSH** ose fondi limit në Euro (sipas kursit të këmbimit i datës 09.10.2024 nga BSH): **568,725.93** (pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e njëzet e pesë pik nëntëdhjetë e tre) Euro pa TVSH.

**LOTI 1 - “Blerje materiale mjekimi specifike për Kirurgji gastrointestinale dhe laparoskopike në SUT”**, me fond limit: **44,351,956.67** (dyzet e katër milionë e treqind e pesëdhjetë e një mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë pik gjashtëdhjetë e shtatë) **lekë pa TVSH** ose fondi limit në Euro (sipas kursit të këmbimit i datës 09.10.2024 nga BSH): **449,270.23** (katërqind e dyzet e nëntë mijë e dyqind e shtatëdhjetë pik njëzet e tre) Euro pa TVSH.

**LOTI 2 - “Blerje materiale konsumi për Artroskopinë e SUT**, me fond limit: **11,792,666.67** (njëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pik gjashtëdhjetë e shtatë) **lekë pa TVSH** ose fondi limit në Euro (sipas kursit të këmbimit i datës 09.10.2024 nga BSH): **119,455.70** (njëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e pesë pik shtatë) Euro pa TVSH.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*
- Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi:** këto shtojca janë pjese e setit te dokumenteve standarde te tenderit për procedurën e prokurimit te sipërcituar dhe Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 27 dhe nenin 26 pika 2, germa “e”, nenin 41 pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

## 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë “Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore”, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë, sipas Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore” (e vlefshme vetëm për OE lokalë/vendas).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1** Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate 3 (tre) viteve te fundit financiare (2021, 2022 dhe 2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur ne përputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr 162/2020, ”Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne te cilin gjejmë te përcaktuar: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

**Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore** është bërë bazuar në nenin 43 pika 1, të VKM 285/2021 “Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 ‘Për Tatimin Mbi të Ardhurat’ i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave.*

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

Në piken 2 te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, është përcaktuar vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë e cila nuk mund të tejkalojë:

*a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;*

*b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;*

*c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.*

Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve te kërkuara me poshtë, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për te përmbushur kontratën siç është parashikuar nga AK.

## 2.3 Kapaciteti teknik:

### 2.3.1 Dëshmi nga operatori ekonomik për shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë sa 40% e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.
- Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne te cilin përcaktohet:

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.;

**Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është bazuar** në nenin 40 pika 4, të VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet:

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përpjesëtim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës siç është parashikuar nga AK.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese (të plotësohet në formularin e ofertës)

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga Distributor të Autorizuar nga prodhuesi, për Shqipërinë, për këtë procedurë prokurimi, për tregtimin e artikujve të ofruar.

*Shënim: Në rastin e distributorit të autorizuar për Shqipërinë të provohet lidhja me prodhuesin nëpërmjet dokumentacionit përkatës.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar për të njohur origjinën e mallrave dhe për të vërtetuar lidhjen e OE me prodhuesin ose distributorin e autorizuar, bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe neni 40, pika 8 të VKM 285 datë 19.05.2021.

**2.3.4** Ofertuesi duhet të jetë i certifikuar ISO 9001:2015 për import, eksport, tregtim të materialeve mjekësore /ose/ ekuivalent. Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse, të vlefshme. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti FDA ose CE ose ekuivalent, të vlefshme, për të gjithë artikujt (kur është e aplikueshme) e ofruar sipas kategorizimit të tyre.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar për të vërtetuar që malli i plotëson kërkesat e cilësisë, bazuar në nenin 44, pika 1 të VKM 285 datë 19.05.2021 i ndryshuar.

**2.3.6** Kërkohen të paraqiten katalogë teknike për të gjithë artikujt e ofruar. Në katalogë, artikujt dhe specifikimet teknike të tyre duhet të markohen me ngjyrë të ndezur sipas numrit rendor të përcaktuar në formularin e ofertës. (Katalogët duhet të ngarkohen në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT).

**2.3.7** Kërkohen të paraqiten mostra për artikujt e shenjuar me (\*) sipas formularit të specifikimeve teknike. Dorëzimi i Kampioneve/mostrave, të bëhet pranë Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, zyra e prokurimeve SUT, të mbyllura në një zarf /kuti jo transparente të vulosur mbi të cilin të shënohet:

*-“Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit « ..... » dhe jo para datës dhe orës së përcaktuar.*

*-Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe të firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.*

*-Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënojë Nr. Rendor të Artikullit që përfaqëson.*

*-Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qarte origjina e mallit, e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar për të vërtetuar që malli i ofruar përmbush specifikimet teknike, bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe neni 40 pika 6, germa a, b, të VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Duke patur parasysh rëndësinë e këtyre materialeve si dhe rekomandimet e APP-se, Ak ka kërkuar mostra për disa nga artikujt objekt prokurimi me qëllim kontrollin e standardeve dhe të cilësisë së mallrave përpara shpalljes së fituesit dhe nënshkrimit të kontratës së furnizimit.

### ***Shënim për operatorët ekonomikë:***

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet:

*“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6 dhe 7, të këtij neni, ku parashikohet:*

6. *“Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.*

*[..]Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

*Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuar me origjinalin.*

*Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij. [..]*

7. *Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.*

**Argumentimi:** Kriteret e vendosura me sipër janë hartuar nga anëtarët e NjP sipas procedurave të ngjashme të realizuara me sukses nga AK si dhe është në përputhje me nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në nenin 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose*

*performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

### **Specifikimet sipas DST-se.**

**Argumentimi:** Specifikimet teknike të mësipërme plotësojnë kushtin për materiale cilësore dhe janë përcaktuar në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, pika 3/b të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **Njësia e Prokurimit:**